



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1178/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Igor Simiqit kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Mitrovicën e Veriut nga radhët e Iniciativa Qytetare GI SDP Oliver Ivanoviq, paraqitur kundër KQZ-së për shkak të parregullsive dhe të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Igor Simiqit kandidat për anëtar të kuvendit komunal, në Mitrovicën e Veriut, nga radhët e Iniciativa Qytetare GI SDP Oliver Ivanoviq.

Arsyetim

PZAP-i, më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Igor Simiqit kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Mitrovicën e Veriut nga radhët e Iniciativa Qytetare GI SDP Oliver Ivanoviq, me të cilën thekson se numërimi i votave të cilat i kanë fituar individualisht kandidatet e tyre për asamble respektivisht rezultatet zyrtare përfundimtare nuk korrespondojnë gjendjen reale dhe nuk përputhen me numrin e votave të cilët i kanë fituar kandidatet e tyre në këto zgjedhje. Andaj sipas parashtresës së ankesës kjo nuk është bere si duhet dhe rezultatet e publikuara nuk korrespondojnë me numrin e vërtet të fletëvotimeve dhe rezultatet të cilat i kanë realizuar kandidatet e tyre dhe se këto të dhëna për votat e fituara individualisht nga kandidatet e të publikuara nga KQZ-ja ndryshojnë shume nga rezultatet të cilat i ka subjekti i tyre politik respektivisht nga të dhënat e shënuara në fletëvotime të cilat janë të shënuara në procesverbal dhe të cilat i kanë transmetuar anëtarët e këshillave të vendvotimeve. Andaj me këtë rast këto sipas parashtresës të ankesës parregullsitë e theksuara kanë të bëjnë me atë se disa nga kandidatet e tyre në baze të dhënave nga KQZ-ja kanë me pak vota se që realisht i kanë fituar, disa kanë me shume e disa që nuk janë në listë do të duheshin të jene në këtë listë në baze të rezultateve të tyre, e disa nga ata që janë në këtë listë do të mbeteshin jashtë asaj liste.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo ndonjë dëshmi bindëse që do ti bënin të besueshme dhe që do ti vërtetonin pretendimet e tilla ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1178/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.